



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-26984/24
Kaçanik, 22.10.2024

Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-048 –Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008) të Ligjit Rr.03/L-221-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048-Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr.08/L-260– Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 26/29 Dhjetor 2023), të nenit 61 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 060/01-26984/24 prej datës 18.10.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 22 tetor 2024, mori këtë:

VENDIM
PËR TRANSFERIN-HARMONIZIMIN E MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË E
PAGAVE DHE SHITESAVE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2024

1. Me këtë Vendim, bëhet Transferi i mjeteve nga kategoria e Pagave dhe Shtesave (fondi 10), nga nën programet buxhetore, si vijon:

- 1.1 Zyra e Kuvendit Komunal (16928), kodi funksional 0111, shuma prej 1,500.00€;
- 1.2 Buxhetimi (17528), kodi funksional 0112, shuma prej 2,500.00€;
- 1.3 Infrastruktura rrugore (18028), kodi funksional 0451, shuma prej 10,000.00€;
- 1.4 Bujqësia (47028), kodi funksional 0421, shuma prej 6,700.00€;
- 1.5 Pylltaria dhe Inspeksioni (47108), kodi funksional 0422, shuma prej 8,800.00€;
- 1.6 Administrata (92140), kodi funksional 0980, shuma prej 9,000.00€;
- 1.7 Arsimi parashkollor (92750), kodi funksional 0911, shuma prej 18,000.00€;
- 1.8 Arsimi i mesëm i lartë (95010), kodi funksional 0922, shuma prej 35,000.00€;
- 1.9 Shërbimet Kulturore (85028), kodi funksional 0820, shuma prej 8,000.00€;
- 1.10 Shërbimet e Shëndetësisë Primare (74700), kodi funksional 0721, shuma prej 38,100.00.

2. Shuma e mjeteve nga paragrafët e pikës 1. të këtij Vendimi, Transferohen në nën programet buxhetore, si vijon:

- 2.1 Administrata (73037), kodi funksional 0760, shuma prej 1,000.00€;
- 2.2 Çështje gjinore (16528), kodi funksional 0412, shuma prej 450.00€;
- 2.3 Zyra komunale për komunitete dhe kthim (19640), kodi funksional 1090, shuma prej 500.00€;
- 2.4 Shërbimet Sociale-Kaçanik (75636), kodi funksional 1040, shuma prej 5,650.00€;
- 2.5 Zjarrfikësit dhe Inspektimet (18432), kodi funksional 0320, shuma prej 45,000.00€;
- 2.6 Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93810), kodi funksional 0912, shuma prej 85,000.00€.

3. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante);
3. Arkivi.

